

Syndhet rritja e cilësisë në arsimin e lartë



Prishtinë, 26 mars - Ministria e Arsimit dhe Wus Austria, në bashkëpunim me partnerët e tjera vendës dhe evropianë, e kanë iniciuar projektin "Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë", me qëllim të kontribuimit për themelimin, forcimin dhe sigurimin e cilësisë në 10 institucionë private të arsimit të lartë të Kosovës. Kështu u tha në një konferencë për shtyp, të premten, e organizuar nga Ministria e Arsimit. Ministri i kësaj ministrie, Enver Hoxhaj, tha

se qëllimi afatgjatë i këtij projekti ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së këtyre institucioneve në bazë të strategjisë mbi arsimin e lartë për periudhën 2005-2015, parimeve të Procesit të Bolonjës, si dhe dokumenteve të tjera relevante. "Këto institucionë duhet të merren me shkencë, e cila u mundeson ofrimin e standardit të fundit të dijes në mësimdhënien", tha Hoxhaj. Ky projekt është mbështetur nëpërmjet programit TEMPUS dhe është financuar nga Komisioni Evropian. Me këtë rast, përfaqë-

suesja e Komisionit Evropian për Kosovë, Sophie Beaumont, tha se e rendësishmja e këtij projekti është që oferat, të cilat ofrohen nga programet e TEMPUS-it, kanë rezultate për plotësimin e kërkesave të studentëve, e që ndër të tjera është sigurimi i cilësisë.

(d. neziri)

27.03.2009 "LAYM"